Numër: 01-464
Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e II-të e mbajtur me datë 29.05.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

Akreditohet dhe validohet Shkolla e Mesme e Lartë e German Gymnasium Deutsches Gymnasium 001 SH.P.K Bislim Bajgora, 1, 40000, Mitrovicë, Kosovë për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2026 deri 30.08.2029, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1 **Teknologji e Informacionit,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional deri me njëzetegjashtë (26) nxënës në një klase, dhe ne total mund të ofroi deri ne katër (4) klasa brenda vitit shkollor.

1. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Shkolla e Mesme e Lartë e German Gymnasium Deutsches Gymnasium për validim & akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 23.04.2026 për kualifikimin: Teknologji e Informacionit, Niveli III dhe IV sipas KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 29.04.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 13.05.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026

Për një vit kalendarik, lejohen (4) katër klase brenda viti me nga 26 nxënës, që në total bëjnë 104 nxënës (4x26=104) nxënës për një vit. Kjo shifër reflekton kapacitetin aktual të institucionit për të pranuar dhe përkrahur nxënësit në kuadër të këtij kualifikimi.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. German Gymnasium, Mitrovice
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK